




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. <u>2-D/DPK</u> Nr. I faq. Broj stranica Nr. pages <u>02</u>	Nr. Prot. Br. Prot. <u>01-3946/13</u> Prot No. Data Datum <u>18.11.2013</u> Date PRISHTINË



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE  
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 (paragrafi 1.1), nenin 5 (paragrafi 1.5) dhe nenin 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 24 (paragrafi 11 dhe 12) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 15.11.2013, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

**I. Mbyllet rasti me nr. AKK – 03-3036/13, për z. Zenel Kuçi – Drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Inspektion në Komunën e Junikut, për arsye se i njëjti ka shmangur situatën e mundshme të konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

**A r s y e t i m**

**I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funkcionit Publik, nr. AKK – 03-3036/13, për zyrtarin e lartë z. Zenel Kuçi – Drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Inspektion në Komunën e Junikut, dhe njëkohësisht person i autorizuar në biznesin privat N.P.T. “Zam - Lina”, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.**

Në këtë rast, zyrtari i lartë z. Kuçi është njoftuar me shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit për fillimin e procedurës së shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit lidhur me funksionin e tij publik.

Pas pranimit të kësaj shkrese, zyrtari në fjalë, është paraqitur në takim me zyrtarët e Agjencisë dhe atij i është sqaruar situata në të cilën ndodhet. Në këtë takim ai ka konfirmuar se në cilësinë e zyrtarit të lartë e ushtron pozitën e Drejtorit të Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Inspektion në Komunën e Junikut, dhe njëkohësisht është person i autorizuar në biznesin privat N.P.T. “Zam - Lina”.

Zyrtari i lartë publik ka kuptuar situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, prandaj pas rekomandimit të Agjencisë, ka premtuar se do të autorizoj një person të besueshëm që të udhëheq kompaninë.

Pas kësaj, z. Kuçi, ka dërguar informacionin zyrtar të lëshuar nga Agjensioni i Regjistrimit të Bizneseve (DPKI 03-3724/13) në të cilën vërtetohet se i njëjti ka hequr dorë nga të qenurit person i autorizuar në biznesin e lartpërmendur dhe ka autorizuar një person të besueshëm për udhëheqjen e këtij biznesi.

Prandaj, duke pasur parasysh këto të dhëna, konstatojmë se është shmangur situata e mundshme të konfliktit të interesit.

Andaj u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

Hasan Preteni

